



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 158, Datë 05.06.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“GREENSOL” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 05.06.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1662/1 prot., datë 03.06.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “GREENSOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GREENSOL” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1662 prot., datë 22.05.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, Qarku Vlorë, me kapacitet të instaluar 49.96 MW.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të *Rregullores*, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas gërmave (a, b dhe c), duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën 1.
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të *Rregullores*, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas gërmave (a, b, c dhe d).

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas gërmave (a dhe c).
- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas gërmave (b dhe d).

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

Shoqëria “GREENSOL” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Kontratën nr. 602 Rep., nr. 164 Kol., datë 10.02.2026 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 49.96 MW dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bisticë, Bashkia Finiq, Qarku Vlorë, nga shoqëria “GREENSOL” sh.p.k.”;
- Është pajisur me miratimin në parim për lidhjen e centralit me rrjetin e transmetimit nëpërmjet shkresës me nr. 1994/2 prot., datë 23.05.2025, të shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a.

Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të japë sqarimet përkatëse në lidhje me stafin teknik efektiv.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të dokumentojë në ERE mbështetjen financiare për 20% e mbetur të vlerës totale të investimit të projektit.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- **gërma “a”**: Shoqëria duhet të depozitojë një garanci për panelet që parashikon të përdorë, në rast se e disponon, për të rakorduar afatin e vlefshmërisë së licencës, si dhe të përcaktojë një datë specifike në të cilën parashikon të fillojë operimin e centralit.
- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të bëjë me dije në rast se ka nënshkruar Marrëveshjen Përfundimtare me OST sh.a. dhe nëse po, ta depozitojë atë në ERE.
- **gërma “e”**: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE një VNM Paraprake të përditësuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GREENSOL” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 49.96 MW, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, Qarku Vlorë.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “GREENSOL” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI